



KOLEGJI  
UNIVERSITAR  
QIRIAZI



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot, më datë 20 Tetor 2017, në Tiranë, ndërmjet palëve të mëposhtme:

Kolegji Universitar “Qiriazi”, me seli në Tiranë, rruga Taulantët Kodër Kamëz, NIPT K6183001Q përfaqësuar nga administratori MSc. Rakela Kapo

dhe

Audituesit ligjor, z. Armand Hasko me numër 299 të licensës profesionale i regjistruar në QKB më datë 04/02/2013 i pajisur me NIPT L31404018E me adresë të selisë rruga “Frosina Plaku”, Pallati HOME PLAN, shkalla 5, Ap 532 Tiranë

Dhe tani e tutje si PALË, që udhëhiqen nga interesat e përbashkëta, dhe që kanë për qëllim intensifikimin e marrëdhënieve reciproke dhe bashkëpunuese,

### PALËT BIEN DAKORT:

Të lidhin këtë marrëveshje si më poshtë:

#### Neni 1

#### Objekti dhe Qëllimi

Marrëveshja mes Kolegjit Universitar Qiriazi dhe Audituesit Ligjor z. Armand Hasko ka për objekt:

- bashkëpunimin reciprok profesional mes palëve në funksion të nevojave të Kolegjit, për konsulencën kontabile e fiskale në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara në Shqipëri
- ky bashkëpunim nuk është një proces auditimi ligjor, pasi Kolegji Universitar “Qiriazi”, me seli në Tiranë duke ju referuar treguesve të pasqyrave financiare nuk i plotëson kushtet për auditimin ligjor, ndaj bashkëpunimi do të jetë në orientimin profesional të zbatimit të standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara sipas kërkesave specifike të nevojave të biznesit.
- organizimin dhe pjesëmarrjen e palëve në aktivitete të përbashkëta me interes për Kolegjin dhe stafin administrativ financiar të Kolegjit Universitar Qiriazi.



AUDITUES LIGJOR Lic.299  
ARMAND HASKO  
NIPT: L 31404018 E

Palët mund të negociojnë zgjerimin e fushëveprimit së kësaj marrëveshjeje. Në çdo rast ndryshimet do të shkëmbehen në formë zyrtare me shkrim.

#### **Neni 4 Dispozitat e fundit**

Marrëveshja hartohet dhe nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe me të njëjtën vlerë juridike. Palët angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 20 Tetor 2017 dhe hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj.

**Kolegji Universitar “Qiriazi”**  
**Administratori**  
**Rakela Kapo**



**Audituesi Ligjor**  
**Armand Hasko**

